



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 593/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit N.T.SH. “N...”, me seli në fshatin, Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.326/2019 të datës 27.12.2019, të Përmbartuesit Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datën 07.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.T.SH. “N...” dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.326/2019, i datës 27.12.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, për pjesën e kamatës prej 0.65% mujore (7.80% vjetore) prej datës 31.12.2018, e deri në pagesën përfundimtare.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.326/2019, i datës 27.12.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 31,013.99 € (tridhjetë e një mijë e trembëdhjetë euro e nëntëdhjetë e nëntë cent).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Dogana e Kosovës, ndaj debitorit N.T.SH. “N...”, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 326/2019 të datës 27.12.2019, të Përmbartuesit Privat Ilmi Miftaraj, për pjesën e kamatës prej 0.65% mujore (7.80% vjetore) prej datës 31.12.2018, e deri në pagesën përfundimtare.

A r s y e t i m

Kreditori, Dogana e Kosovës ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit N.T.SH. “N....”, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbarues – Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Kontrollës Pas-Importuese, nr. 03.1.1-2018-122/1, të datës 15.10.2018, i ndryshuar me Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/640, të datës 05.12.2018, i formës së prerë me datë 21.01.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 22.02.2019, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të detyrimeve doganore për taksa doganore, akciza dhe TVSH, t’ia paguaj shumën prej 31,013.99 € (tridhjetë e një mijë e trembëdhjetë euro e nëntëdhjetë e nëntë cent).

Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, me datë 27.12.2019, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 326/2019, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Kontrollës Pas-Importuese, nr. 03.1.1-2018-122/1, të datës 15.10.2018, i ndryshuar me Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/640, të datës 05.12.2018, me të cilin është detyruar debitori që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 31,013.99 € (tridhjetë e një mijë e trembëdhjetë euro e nëntëdhjetë e nëntë cent), me kamatë mujore prej 0.65% (7.80% vjetore) prej datës 31.12.2018, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë, ndërsa përmbushja të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme, kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet tjera të krijuara, sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori N.T.SH. “N....”, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, në të cilin ka deklaruar se kundër këtyre aktvendimeve është inicuar procedura e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe vendimi nuk është i formës së prerë, andaj procedura duhet të ndërpritet derisa të vendos gjykata kompetente. I ka propozuar gjykatës që procedura përmbarimore të ndërpritet dhe të refuzohet urdhri përmbarimor si i pabazuar.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se prapësimi është i pabazuar dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të refuzohet. Në lidhje me pretendimet e debitorit se ka parashtruar padi dhe ka inicuar konfliktin administrativ, ka deklaruar se pretendimi i tillë është i pabazuar, sepse sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ. Tutje ka shtuar se kreditori propozimin për përmbarrim e ka parashtruar duke u bazuar në aktvendimin e nxjerrë në procedurë administrative i cili është i ekzekutueshëm dhe sipas nenit 22 të LPP-së përbën titull ekzekutiv dhe si i tillë propozimi për përmbarrim i parashtruar nga kreditori i plotëson të gjitha kushtet dhe është i përshtatshëm për përmbarrim sipas nenit 23 par.2 dhe nenit 24 par.1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaket si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Aktvendimin e Doganës së Kosovës, Sektori i Kontrollës Pas-Importuese, nr. 03.1.1-2018-122/1, të datës 15.10.2018, i ndryshuar me Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/640, të datës 05.12.2018, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu vendimi, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbarrjes së detyrimit”*, pasi që janë treguar palët, përkatësisht

kreditore dhe debitor, objekti si dhe shumë e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Kontrollës Pas-Importuese, nr. 03.1.1-2018-122/1, të datës 15.10.2018, i ndryshuar me Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/640, të datës 05.12.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Kontrollës Pas-Importuese, nr. 03.1.1-2018-122/1, të datës 15.10.2018, i ndryshuar me Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/640, të datës 05.12.2018, është bërë i formës së prerë me datë 21.01.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 22.02.2019.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*. Andaj fakti se debitor ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore.

Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përmbarimor P.nr. 326/2019 të datës 27.12.2019, të Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbarimor, mirëpo konstatoi se me dokumentin përmbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, debitor është obliguar që në emër të detyrimeve doganore për taksa doganore, akciza dhe TVSH, t’ia paguaj kreditorit shumë prej 31,013.99 € (tridhjetë e një mijë e trembëdhjetë euro e nëntëdhjetë e nëntë cent), mirëpo jo edhe kamatën prej 0.65% mujore (7.80% vjetore), dhe si i tillë urdhri përmbarimor nuk është në përputhje me

dokumentin përmbartimor, andaj gjykata të njëjtin e shfuqizoi pjesërisht vetëm sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.593/22, datë 07.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.